



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“INSTALIME DHE MIRËMBAJTJE TË LINJAVE TË TENSIONIT TË ULËT, TENSIONIT TË MESËM DHE TENSIONIT TË LARTË”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

E10-III-26

Tiranë 2026

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtje

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-05-III-0493-26 Bazat e elektroteknikës në T.U., T.M. dhe T.L.	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-05-III-0494-26 Sistemi energjetik.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-05-III-0495-26 Vizatimi teknik në sistemin elektrik.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-05-III-0496-26 Pajisjet, mjetet dhe materialet e punës në T.U., T.M. dhe T.L.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-05-III-0497-26 Instalimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11

Kriteret e vlerësimit	11
NjN-05-III-0498-26 Instalimi i rrjetit të linjave të tensionit të lartë	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-05-III-0499-26 Instalimi i rrjetit të tensionit të lartë në nënstacionin elektrik.....	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-05-III-0500-26 Instalimi i kabinës elektrike.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-05-III-0501-26 Sistemi i matjes së energjisë elektrike.....	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-05-III-0502-26 Mirëmbajtja e rrjetit të T.U.-T.M.-T.L	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	22
Kriteret e vlerësimit	22
NjN-05-III-0503-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në T.U., T.M. dhe T.L.....	23
Rezultatet e të nxënit në njohuri	23
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit	23
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	24
Modalitetet e vlerësimit	24
Informacion shtesë	25
SHËNIM	25

Emërtimi i kualifikimit	“Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë”			Kodi
Kohëzgjatja	3300-4500 orë nacionale	Niveli	III KSHK, referuar nivelit III të KEK,	E10-III-26
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me profilin.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin “Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë” niveli III në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Pas përfundimit me sukses të kualifikimit profesional “Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë”, niveli III në KSHK, me kohëzgjatje 3 vite shkollore, pas përfundimit të arsimit bazë, individit pajiset me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe suplementin përkatës ose del në tregun e punës si punonjës i kualifikuar. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar, si elektrikist në kompani të ndryshme private/shtetërore të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, montimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të T.U., T.M. dhe T.L., si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individ mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e sistemit energjetik. Gjithashtu, përfundimi i këtij niveli lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në nivelin IV në KSHK, arsim profesional njëvjeçar (nivel teknik/menaxherial), me qëllim përfitimin e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” ose në kursin urë, të përgjithshëm, dhe pas përfundimit të njërit nga këto kualifikime mund të vazhdojë studime pas të mesme ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “**Instalime dhe mirëmbajtje të linjave të tensionit të ulët, tensionit të mesëm dhe tensionit të lartë**” niveli III në KSHK, referuar nivelit të III të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë në mënyrë të drejtë procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë rritje dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-05-III-0493-26 Bazat e elektroteknikës në T.U., T.M. dhe T.L.

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përkufizojë konceptet bazë të elektroteknikës (fushë elektrike, fushë magnetike, ngarkesë elektrike, rryma elektrike, potenciali, tensioni, rezistenca, fuqia elektrike);
2. Të dallojë njësitë matëse të madhësive elektrike (A, V, Ω , W);
3. Të interpretojë ligjet themelore të elektroteknikës;
4. Të shpjegojë ligjet e elektroteknikës për llogaritjen e qarqeve elektrike;
5. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionimin e një skeme elektrike;
6. Të shpjegojë lidhjet elektrike në seri, në paralel, yll-trekëndësh tek qarqet 3-fazorë;
7. Të shpjegojë relacionin ndërmjet rrymave dhe tensioneve për mënyra të ndryshme lidhjeje yll/trekëndësh dhe anasjelltas;
8. Të dallojë burimet e rrymës DC (bateri, akumulatorë) dhe AC (gjeneratorë, rrjeti elektrik);
9. Të përshkruajë mënyrat e prodhimit të rrymës alternative;
10. Të përshkruajë formën valore të rrymës alternative dhe parametrat kryesorë të saj (frekuenca, amplituda, periudha);
11. Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së parametrave të elementëve R, L, C;
12. Të shpjegojë qarqet e përbëra të rrymës alternative me elementet R, L, C;
13. Të përshkruajë dukurinë e rezonancës së rrymave dhe të tensioneve;
14. Të shpjegojë llojet e fuqisë në qarqet e rrymës alternative;
15. Të shpjegojë çfarë është koeficienti i fuqisë dhe rëndësinë e tij;
16. Të interpretojë ndryshimet kryesore ndërmjet AC dhe DC në aspektin e transmetimit dhe përdorimit praktik;
17. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të rrymës alternative në transmetimin e energjisë elektrike në linjat T.M. dhe T.L.;
18. Të shpjegojë elementet përbërëse të skemave elektrike.
19. Të shpjegojë llojet e aparateve matëse dhe kontrolluese (ampermetër, volmetër, ohmetër etj.);
20. Të shpjegojë rolin e rrymës operative dhe mënyrat e përfutimit të saj;
21. Të dallojë nivelet e tensionit (T.U., T.M., T.L.) dhe përdorimet e tyre në rrjetin elektrik.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të llogarisë parametrat e qarqeve elektrike duke zbatuar ligjet bazë të elektroteknikës;
2. Të ndërtojë qarqe elektrike me lidhje të ndryshme;
3. Të kryejë matje të parametrave të qarqeve elektrike me instrumentet përkatëse;
4. Të ndërtojë skema elektrike;

Kriteret e vlerësimit

- Llogarit parametrat e qarqeve të rrymës së vazhduar, sipas ligjeve bazë të elektroteknikës;
- Llogarit parametrat e qarqeve të rrymës alternative, sipas ligjeve bazë të elektroteknikës;
- Ndërton qarqe me elementë të lidhur në paralel, sipas projektit;
- Ndërton qarqe me elementë të lidhur në seri, sipas projektit;
- Ndërton qarqe me elementë të lidhur në yll-trekëndësh, sipas projektit;
- Kryen matje të parametrave në qarqet e rrymës së vazhduar, sipas procedurës;
- Kryen matje të parametrave në qarqet e rrymës alternative, sipas procedurës;
- Kryen matje të tensionit, rrymës dhe rezistencës duke përdorur instrumentet përkatëse matëse;
- Llogarit parametrat e qarqeve me elementë R, L, C, sipas ligjeve bazë të elektroteknikës;
- Realizon montimin e qarqeve të thjeshta me elementë R, L dhe C;
- Kontrollon funksionimin e qarqeve AC me elementë R, L, C;

- Lidh saktë ampermetrin, voltmetrin dhe ohmetrin në një qark prove
- Llogarit raportin midis rrymave dhe tensioneve për mënyra të ndryshme lidhjeje yll/trekëndësh dhe anasjelltas, sipas skemave përkatëse;
- Identifikon në skema ose në laborator elementët bazë të qarkut elektrik (burim, përçues, ngarkesë, ndërprerës);
- Ndërton skema elektrike duke zgjedhur elementët, sipas projektit;
- Përzgjedh aparatet e matjes dhe kontrollit, sipas madhësive elektrike të kërkuara;
- Përdor aparatet e matjes dhe kontrollit, sipas madhësive elektrike të kërkuara.

NjN-05-III-0494-26 Sistemi energjetik

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë strukturën e Sistemit Energjetik Shqiptar;
2. Të përshkruajë funksionin e Sistemit Energjetik si zinxhir prodhimi, transmetimi, shpërndarje;
3. Të rendisë institucionet kryesore të Sistemit Energjetik;
4. Të përshkruajë rolin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE);
5. Të shpjegojë rëndësinë e konsumatorit në furnizimin me energji elektrike;
6. Të shpjegojë lidhjen me rrjetin rajonal (linjat e interkoneksionit) (import-eksport energjie);
7. Të shpjegojë mënyrat e prodhimit të energjisë (Hidrocentrale, Termocentrale, Fotovoltaike dhe Eolike);
8. Të shpjegojë çfarë është rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike dhe funksionin e tij;
9. Të shpjegojë llojet e linjave (linja ajrore dhe linja kabllore) dhe dallimet midis tyre;
10. Të shpjegojë funksionin e nënstacioneve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike;
11. Të shpjegojë çfarë është rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike dhe funksionin e tij;
12. Të shpjegojë llojet e rrjeteve (urban dhe rural) dhe dallimet midis tyre;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë strukturën e Sistemit Energjetik;
2. Të identifikojë rrjetin energjetik;
3. Të dallojë prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.;
4. Të dallojë llojet e linjave dhe nivelet e tensionit.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë strukturën e Sistemit Energjetik;
- Specifikon funksionin e Sistemit Energjetik si zinxhir prodhimi, transmetimi, shpërndarje;
- Identifikon institucionet kryesore të Sistemit Energjetik, sipas specifikave përkatëse;
- Interpretin rolin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE);
- Dallon kategorinë e konsumatorit sipas rëndësisë së furnizimit me energji elektrike;
- Interpretin lidhjen sistemit energjetik me rrjetin rajonal (linjat e interkoneksionit) (import-eksport energjie);
- Identifikon mënyrat e prodhimit të energjisë (ujë, erë, diell dhe lëndë djegëse);
- Dallon funksionin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike;
- Dallon linjat sipas llojit (linja ajrore dhe linja kabllore);
- Dallon ndryshimet midis linjës ajrore dhe linjës kabllore;

- Identifikon funksionin e nënstacioneve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike;
- Dallon rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Identifikon funksionin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Identifikon llojin e rrjetit (urban dhe rural);
- Dallon ndryshimet midis rrjetit urban dhe rural;
- Identifikon nivelet e tensionit në sistemin energjetik (T.U., T.M., T.L.);
- Dallon funksionin e centraleve prodhuese sipas llojit të tyre;
- Interpretin rrjedhën e energjisë elektrike nga prodhimi deri te konsumatori final;
- Identifikon burimet alternative;
- Interpretin rëndësinë e sigurisë dhe vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike.

NjN-05-III-0495-26 Vizatimi teknik në sistemin elektrik

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe rolin e vizatimit teknik;
2. Të shpjegojë mënyrën e vizatimit të prerjes së objekteve të thjeshta;
3. Të shpjegojë mënyrën e vizatimit të objekteve në aksionometri;
4. Të identifikojë llojet e vizatimeve që përdoren në linjat elektrike (skema elektrike, planimetri.);
5. Të interpretojë simbolet standarde elektrike në skica dhe vizatime;
6. Të analizojë skema elektrike të linjave (duke kuptuar rrjedhën e energjisë dhe lidhjet ndërmjet elementeve);
7. Të përshkruajë standardet dhe rregullat e vizatimit teknik (shkalla, shenjat konvencionale, përmasat);
8. Të shpjegojë mënyrën e realizimit të skicave dhe vizatimeve të thjeshta për linjat elektrike;
9. Të shpjegojë mënyrën e vizatimit në programe kompjuterike;
10. Të identifikojë gabimet në vizatime duke propozuar korrigjime.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të përdorë mjetet dhe standardet e vizatimit teknik për realizimin e vizatimeve profesionale;
2. Të realizojë vizatime teknike, prerje, aksonometri dhe skica të rrjetit elektrik;
3. Të përdorë programe kompjuterike për realizimin e vizatimeve dhe skemave elektrike;
4. Të kryejë kontrollin, korrigjimin dhe organizimin e dokumentacionit teknik të vizatimeve.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor mjetet e vizatimit teknik sipas rregullave përkatëse;
- Realizon saktë vizatime teknike sipas standardeve;
- Realizon prerje të objekteve të thjeshta sipas kërkesave teknike;
- Realizon saktë vizatime të objekteve në aksonometri;
- Realizon skicime të ndryshme sipas projektit;
- Vizaton skema të thjeshta elektrike sipas projektit;
- Përdor shkallën në vizatime teknike sipas kërkesës;
- Vendos saktë përmasat në vizatimet teknike;
- Identifikon simbolet e elementëve elektrik në vizatime dhe skica;
- Vendos simbolet e elementëve elektrik në vizatime dhe skica, sipas standardeve;

- Identifikon llojet e programeve kompjuterike për vizatime teknike;
- Përdor programet kompjuterike përkatëse për realizimin e vizatimeve teknike;
- Realizon skema elektrike bazë në programe kompjuterike;
- Kontrollon saktësinë e vizatimeve teknike;
- Identifikon gabimet në vizatime, sipas standardeve teknike;
- Propozon korrigjime të gabimeve në vizatim sipas standardeve teknike;
- Organizon dokumentacionin teknik të vizatimeve;
- Paraqet vizatimin teknik sipas kërkesave profesionale.

NjN-05-III-0496-26 Pajisjet, mjetet dhe materialet e punës në T.U., T.M. dhe T.L.

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë llojet e pajisjeve në sistemin e energjisë elektrike;
2. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e transformatorit të Fuqisë;
3. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e transformatorit të rrymës;
4. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e transformatorit të tensionit;
5. Të shpjegojë llojet e pajisjeve komutuese (çelës, çelë, ndarës etj.), ndërtimin dhe funksionin e tyre;
6. Të shpjegojë llojet e pajisjeve mbrojtëse (siguresë, shkarkues, rele etj.) ndërtimin dhe funksionin e tyre;
7. Të shpjegojë llojet e matësve të energjisë, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
8. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e panelit të shpërndarjes, kasetës shpërndarëse dhe panelit të matjes;
9. Të shpjegojë funksionin e baterisë, radrizatorit dhe inverterit;
10. Të shpjegojë llojet e kabujve, përbërjen dhe funksionin e tyre;
11. Të shpjegojë llojet e nyjeve bashkuese të kabujve;
12. Të shpjegojë llojet e shtyllave, përbërjen dhe funksionin e tyre;
13. Të shpjegojë llojet e përcjellësve, përbërjen dhe funksionin e tyre;
14. Të shpjegojë elementet e linjave ajrore, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
15. Të shpjegojë elementet e linjave ajrore me kabëll, me vetëmbajtje ABC, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
16. Të shpjegojë elementet e sistemeve të tokëzimit, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
17. Të shpjegojë llojet e veglave të punës dhe funksionin e tyre;
18. Të shpjegojë ndërtimin e kondensatorëve dhe funksionin e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të dallojë pajisjet e punës në sistemin e energjisë elektrike;
2. Të dallojë transformatorët, pajisjet komutuese, mbrojtëse dhe matëse në sistemin elektrik;
3. Të dallojë elementët e rrjeteve elektrike dhe linjave (ajrore, kabllorë, ABC);
4. Të dallojë komponentët e shpërndarjes dhe furnizimit elektrik (panelet, kasetat, bateri, inverter, radrizator);
5. Të dallojë elementët e kabllorëve dhe lidhjeve bashkuese në instalime elektrike;
6. Të dallojë shtyllat, përcuesit dhe sistemin e tokëzimit në rrjetet elektrike.

Kriteret e vlerësimit

- Dallon pajisjet në sistemin e energjisë elektrike sipas funksionit dhe projektit;

- Dallon transformatorin e fuqisë sipas projektit;
- Dallon transformatorin e rrymës sipas projektit;
- Dallon transformatorin e tensionit sipas projektit;
- Dallon çelësat komutues sipas projektit;
- Dallon çelat komutuese sipas projektit;
- Dallon ndarësat komutuese, sipas projektit;
- Dallon siguresat mbrojtëse, sipas projektit;
- Dallon shkarkuesat mbrojtëse, sipas projektit;
- Dallon reletë mbrojtëse, sipas projektit;
- Dallon matësin e energjisë, sipas projektit;
- Dallon panelin e shpërndarjes, sipas projektit;
- Dallon kasetën shpërndarëse sipas projektit;
- Dallon panelin e matjes, sipas projektit;
- Dallon bateritë, sipas projektit;
- Dallon radrizatorët, sipas projektit;
- Dallon inverterat, sipas projektit;
- Dallon kabëllat, sipas projektit;
- Dallon nyjet bashkuese të kabëllave, sipas projektit;
- Dallon shtyllat, sipas projektit;
- Dallon përcjellësat, sipas projektit;
- Dallon elementet e linjave ajrore T.M.dhe T.U., sipas projektit;
- Dallon elementet e linjave ajrore me kabëll, me vetëmbajtje ABC, sipas projektit;
- Dallon elementet e sistemit të tokëzimit, sipas projektit;
- Dallon kondensatorët, sipas projektit;
- Përzgjedh veglat e punës sipas procesit të punës dhe përdorimit të tyre.

NjN-05-III-0497-26 Instalimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm

Rezultatet e të nxënimit në njohuri

1. Të përshkruajë procesin e instalimit të kasetave shpërndarëse të T.U.;
2. Të shpjegojë përzgjedhjen e kokave të kabllit dhe bashkueseve (muftëve/xhuntëve) të T.U. dhe T.M.
3. Të shpjegojë procesin e instalimit të kokave të kabllit dhe bashkueseve (muftëve/xhuntëve) të T.U. dhe T.M.;
4. Të shpjegojë procesin e instalimit të kabëllit të TU dhe T.M. në kanal;
5. Të përshkruajë hapjen dhe mbylljen e kanalit për shtrim e kablllove të T.U. dhe T.M. dhe standardet përkatëse;
6. Të shpjegojë sistemin e tokëzimit dhe pjesët përbërëse të tij;
7. Të shpjegojë procesin e tokëzimit të kasetës shpërndarëse;
8. Të shpjegojë procesin e tokëzimit të neutrit në kasetën shpërndarëse;
9. Të shpjegojë pjesët përbërëse të tokëzimit të traversave të linjave të T.M.
10. Të shpjegojë procesin e tokëzimit të traversave të linjave të T.M.
11. Të shpjegojë pjesët përbërëse të tokëzimit të neutrit në linjat e T.U. ajrore me kabëll ABC;
12. Të shpjegojë procesin e instalimit të sistemit të tokëzimit të neutrit në linjat e T.U. ajrore me kabëll ABC.

13. Të shpjegojë vlerat e lejuara të rezistencës së tokëzimit;
14. Të përshkruajë aparatet e matjes së rezistencës së tokëzimit dhe mënyrën e matjes së saj;
15. Të shpjegojë pjesët përbërëse të linjës ajrore të T.U. me kabëll ABC;
16. Të shpjegojë parametrat dhe standardet e hapjes së gropave të shtyllave të linjave të T.U dhe T.M.;
17. Të shpjegojë procesin e instalimit të shtyllave me makineri dhe me krah të linjave të T.U dhe T.M.;
18. Të shpjegojë pjesët përbërëse të linjës T.U. dhe T.M. me përcjellës të zhveshur;
19. Të shpjegojë llojet e traversave të linjës T.U. dhe T.M. dhe funksionin e tyre;
20. Të shpjegojë llojet e izolatorëve të linjës T.U. dhe T.M. dhe funksionin e tyre;
21. Të shpjegojë llojet e morsetave dhe funksionin e tyre;
22. Të përshkruajë procesin e instalimit të përcjellësve të linjës T.U. dhe T.M.
23. Të përshkruajë procesin e instalimit të traversave të linjës T.U. dhe T.M.
24. Të përshkruajë procesin e instalimit të izolatorëve të linjës T.U. dhe T.M.
25. Të shpjegojë çfarë është bandazhimi i përcjellësve dhe kur realizohet ai;
26. Të përshkruajë procesin e instalimit të morsetave dhe bandazheve të linjës T.U. dhe T.M.
27. Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në rrjetin e T.U. dhe T.M.;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e kasetave shpërndarëse të T.U.;
2. Të kryejë përgatitjen, instalimin dhe bashkimin e kablllove të T.U. dhe T.M., duke përfshirë kokat e kablllove dhe bashkueset (muftë/xhunto);
3. Të zbatojë procedurat e shtrimit të kablllove T.U. dhe T.M., në kanale, mure dhe konstruksione metalike/plastike;
4. Të kryejë instalimin dhe realizimin e sistemit të tokëzimit, për kasetat, neutrin dhe elementët e linjave T.U. dhe T.M.;
5. Të instalojë elementët e linjave ajrore T.U. dhe T.M. (përfshirë ABC dhe përcjellës të zhveshur), si shtylla, traversa, izolatorë, morseta dhe përcjellës;
6. Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe procedurat teknike gjatë punës në rrjetet shpërndarëse T.U. dhe T.M.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon dhe interpreton projektin e rrjetit T.U. dhe T.M.;
- Verifikon përputhshmërinë e materialeve dhe pajisjeve me projektin dhe standardet;
- Përgatit vendin e punës dhe kushtet teknike për instalim të sigurt;
- Kontrollon gjendjen teknike të kablllove, pajisjeve dhe elementeve para instalimit;
- Përzgjedh llojin e kasetës sipas vendit të montimit dhe ngarkesës elektrike (amper);
- Instalon kasetën shpërndarëse të T.U. brenda në mur sipas procedurës;
- Instalon kasetën shpërndarëse të T.U. jashtë murit sipas procedurës;
- Instalon pjesët përbërëse të kasetës (izolatorë mbështetës, automate, rrepina etj.) sipas procedurës;
- Instalon terminalet e kablllove në rrepinë sipas procedurës;
- Përzgjedh kokën e kabllit të T.U. sipas seksionit të kabllit që do të instalohej;
- Përgatit kokën e kabllit T.U. sipas procedurës;
- Instalon kokën e kabllit T.U. sipas standardit dhe procedurës;

- Përzgjedh bashkuesen (muften/xhunton) të T.U. sipas seksionit të kabllit që do të instalohet;
- Përgatit bashkuesen (muften/xhunton) të T.U. sipas standardit dhe procedurës;
- Instalon bashkuesen (muften/xhunton) të T.U. sipas procedurës;
- Përzgjedh bashkuesen (muften/xhunton) të T.M. sipas seksionit të kabllit që do të instalohet;
- Përgatit bashkuesen (muften/xhunton) të T.M. sipas standardit dhe procedurës;
- Instalon bashkuesen (muften/xhunton) të T.M. sipas procedurës;
- Përzgjedh kabllin e T.U. dhe T.M. që do të instalohet në kanal/konstruksione; metalike/konstruksione plastike/mur sipas llojit dhe projektit;
- Zbaton procedurën për hapjen dhe mbylljen e kanalit për shtrimin e kabllove të T.U. dhe T.M., sipas standardeve;
- Zbaton procedurën për përgatitjen e konstruksioneve metalike/konstruksioneve plastike/murit për shtrimin e kabllove të T.U. dhe T.M., sipas standardeve;
- Instalon kabëllin e T.U. dhe T.M. sipas procedurës;
- Përzgjedh elementet e sistemit të tokëzimit të kasetës shpërndarëse, sipas projektit;
- Instalon sistemin e tokëzimit të kasetës shpërndarëse, sipas standardit dhe procedurës;
- Instalon tokëzimin e neutrit në kasetën shpërndarëse;
- Përzgjedh elementet e sistemit të tokëzimit të traversave të linjave të T.M. sipas projektit;
- Instalon sistemin e tokëzimit të traversave të linjave të T.M. sipas standardit dhe procedurës;
- Përzgjedh elementet e sistemit të tokëzimit të neutrit në linjat e T.U. ajrore me kabëll ABC, sipas projektit;
- Instalon sistemin e tokëzimit të neutrit në linjat e T.U. ajrore me kabëll ABC sipas standardit dhe procedurës;
- Realizon matjen e rezistencës së tokëzimit me aparatet përkatës brenda vlerave të lejuara;
- Përzgjedh pjesët përbërëse të linjës ajrore të T.U. me kabëll ABC sipas projektit;
- Instalon pjesët përbërëse të linjës ajrore të T.U. me kabëll ABC sipas standardit dhe procedurës;
- Zbaton procedurat për hapjen dhe mbylljen e gropave të shtyllave të linjave të T.U dhe T.M. sipas parametrave teknik dhe standardeve;
- Instalon shtyllat e linjave të T.U dhe T.M. me makineri/krah sipas standardeve dhe procedurave;
- Përzgjedh pjesët përbërëse të linjës T.U. dhe T.M. me përcjellës të zhveshur sipas projektit;
- Instalon traversat e linjës së T.U. dhe T.M. sipas standardeve dhe procedurave;
- Instalon izolatorët e linjës së T.U. dhe T.M. sipas standardeve dhe procedurave;
- Instalon morsetat e linjës së T.M. dhe T.U. sipas standardeve dhe procedurave;
- Instalon përcjellësat e linjës së T.U. dhe T.M. sipas standardeve dhe procedurave;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në rrjetin shpërndarës të T.U. dhe T.M.;
- Kontrollon dhe verifikon korrektësinë e instalimeve pas përfundimit të punimeve;
- Identifikon dhe korrigjon defektet gjatë procesit të instalimit;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të instalimeve.

NjN-05-III-0498-26 Instalimi i rrjetit të linjave të tensionit të lartë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë elementet e linjës së T.L.
2. Të shpjegojë parametrat dhe standardet e hapjes së gropave të shtyllave të linjave të T.L.
3. Të shpjegojë procesin e instalimit të shtyllave për linjën T.L.;
4. Të përshkruajë zbarat (Përcjellës Cu, ALC, AL me seksione të ndryshme) dhe funksionin e tyre;
5. Të shpjegojë procesin e instalimit të zbarave;
6. Të përshkruajë girlandat (varg izolatorësh të lidhur zinxhirë) dhe aksesoret lidhës të tyre.
7. Të shpjegojë procesin e instalimit të girlandave dhe aksesoreve të tyre;
8. Të përshkruajë llojet e traversat e T.L. dhe funksionin e tyre;
9. Të përshkruajë procesin e instalimit të traversave të T.L.;
10. Të përshkruajë llojet e përcjellësit të trosit dhe funksionin e tyre;
11. Të përshkruajë procesin e instalimit të Trosit;
12. Të shpjegojë llojet e izolatorëve të linjës T.L. (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10,6 kV) dhe funksionin e tyre;
13. Të shpjegojë procesin e instalimit të izolatorëve të linjës T.L.;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të realizojë analizimin e projektit teknik dhe piketimin në terren të trasesë së linjës së tensionit të lartë;
2. Të kryejë përgatitjen e terrenit dhe instalimin e shtyllave të linjës së tensionit të lartë;
3. Të kryejë përzgjedhjen, bashkimin dhe instalimin e përcjellësve, zbarave, trosit dhe aksesoreve të tyre;
4. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e izolatorëve, girlandave, traversave dhe elementëve të tjerë përbërës të linjës së tensionit të lartë;
5. Të kryejë realizimin e sistemit të tokëzimit dhe kontrollin e parametrave teknikë të linjës së tensionit të lartë sipas standardeve;
6. Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe procedurat teknike gjatë instalimit dhe testimit të linjës së tensionit të lartë.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon projektin e zbatimit të linjës T.L.;
- Kontrollon dokumentacionin teknik, materialet, pajisjet dhe veglat e punës përpara fillimit të punimeve;
- Verifikon terrenin dhe kushtet e punës përpara piketimit dhe instalimit;
- Verifikon përputhshmërinë e parametrave të elementëve të linjës me standardet;
- Kryen piketimin e linjës me instrumentet përkatëse në terren, sipas projektit;
- Zbaton procedurën e hapjes dhe mbylljes së gropave të shtyllave sipas projektit dhe standardit;
- Instalon shtyllat për linjën T.L., sipas projektit dhe standardit;
- Realizon tokëzimin e shtyllave dhe elementeve metalike sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh elementët e linjës/zbarave (llojin e përcjellësit Cu, ALC, AL dhe seksionin përkatës) sipas projektit dhe standardit;

- Kryen bashkimin e përcjellësve duke përdorur aksesoret përkatës sipas standardit;
- Instalon përcjellësit ose zbarat, sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh girlandat (vargun e izolatorëve) sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh aksesoret lidhës të girlandave dhe të linjës (morseta krokodil, kapikorda, pllaka metalike që lidh dy ose më shumë vargje izolatorësh, denfera, etj.) sipas projektit dhe standardit;
- Instalon girlandat (vargun e izolatorëve) sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh traversën e T.L., sipas, projektit dhe standardit;
- Instalon traversën T.L., sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh përcjellësin e trosit dhe aksesoret, sipas projektit dhe standardit;
- Instalon përcjellësin e trosit dhe aksesoret, sipas projektit dhe standardit;
- Përzgjedh izolatorët e linjës T.L. (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10,6 kV), sipas projektit dhe standardit;
- Instalon izolatorët e linjës T.L., sipas projektit dhe standardit;
- Kontrollon distancat e sigurisë ndërmjet përcjellësve, shtyllave dhe objekteve përreth sipas standardeve;
- Verifikon qëndrueshmërinë mekanike të shtyllave, traversave dhe aksesoreve të montuar;
- Zbaton rregullat e sigurisë teknike
- Përdor pajisjet mbrojtëse personale gjatë gjithë procesit të punës;
- Kryen kontrollin final të instalimit të linjës sipas projektit teknik;
- Teston linjën para vënies në punë sipas procedurave teknike;
- Identifikon dhe korrigjon defektet ose devijimet gjatë procesit të instalimit;
- Dokumenton punimet e kryera sipas kërkesave teknike;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të instalimit.

NjN-05-III-0499-26 Instalimi i rrjetit të tensionit të lartë në nënstacionin elektrik

Rezultatet e të nxënimit në njohuri

1. Të përshkruajë çfarë është portali i hyrjes në nënstacionin elektrik;
2. Të përshkruajë procesin e instalimit të shkarkuesve (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10kV, 6 kV);
3. Të shpjegojë procesin e instalimit të pajisjeve komutuese (ndarësit, çelësit, çelat etj.) të T.L.;
4. Të shpjegojë procesin e instalimit të transformatorëve të rrymës të T.L (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10kV, 6 kV);
5. Të shpjegojë procesin e instalimit të transformatorëve të tensionit të T.L (110 kV, 35 kV, 20 kV, 10kV, 6 kV);
6. Të shpjegojë procesin e instalimit të transformatorëve të fuqisë të T.L. (nga 1 MVA deri 80 MVA);
7. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e panelit të mbrojtjes;
8. Të shpjegojë procesin e instalimit të panelit të mbrojtjes;
9. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e panelit të kontroll monitorimit;
10. Të shpjegojë procesin e instalimit të panelit të kontroll monitorimit.
11. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e panelit të matjes;
12. Të shpjegojë procesin e instalimit të panelit të matjes;

13. Të shpjegojë elementet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe funksionin e tyre;
14. Të shpjegojë procesin e instalimit të sistemit mbrojtës;
15. Të shpjegojë procesin e instalimit të kablllove të fuqisë së T.L. në një nënstacion;
16. Të shpjegojë procesin e instalimit të kokave të kabllit dhe bashkueseve (muftëve/xhuntëve) për T.L.;
17. Të shpjegojë procesin e instalimit të kablllove të T.U. deri në 1000 V;
18. Të shpjegojë procesin e instalimit të kablllove të rrymës së vazhduar;
19. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e panelit elektrik (shpërndarës panel T.U.) në një Nënstacion;
20. Të përshkruajë procesin e instalimit të sistemit të ndriçimit të jashtëm e të brendshëm;
21. Të përshkruajë procesin e instalimit të sistemit të tokëzimit në Nënstacion;
22. Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në rrjetin e T.L.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë analizimin e projektit të zbatimit dhe përgatitjen për instalimin e portalit hyrës të nënstacionit të tensionit të lartë;
2. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve komutuese dhe mbrojtëse të nënstacionit të T.L. (shkarkues, ndarës, çelësa, çelë);
3. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e transformatorëve të rrymës, tensionit dhe fuqisë në nënstacionin e T.L.;
4. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e paneleve të mbrojtjes, kontroll-monitorimit, matjes dhe panelit elektrik (shpërndarësit T.U.);
5. Të kryejë përzgjedhjen dhe instalimin e kablllove të fuqisë T.L., kablllove T.U., kablllove të rrymës së vazhduar, kokave të kablllove dhe bashkueseve (muftëve/xhuntëve);
6. Të kryejë instalimin e sistemit të tokëzimit, mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike, ndriçimit të brendshëm/jashtëm.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon projektin e zbatimit të portalit të hyrjes së Nënstacionit të T.L.;
- Kontrollon dokumentacionin teknik dhe kushtet e terrenit përpara instalimit;
- Verifikon përputhshmërinë e pajisjeve dhe materialeve me projektin dhe standardet;
- Përgatit vendin e punës dhe siguron kushtet teknike për instalim të sigurt;
- Përzgjedh shkarkuesat e T.L. sipas projektit dhe standardit;
- Instalon shkarkuesat, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh ndarësit, sipas projektit dhe standardit;
- Instalon ndarësit, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh çelësat sipas projektit dhe standardit;
- Instalon çelësat, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh sipas projektit dhe standardit
- Instalon çelat sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh transformatorët e rrymës, sipas projektit dhe standardit
- Instalon transformatorit të rrymës, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh transformatorët të tensionit sipas projektit dhe standardit
- instalon transformatorët të tensionit, sipas procedurës dhe standardit;

- Përzgjedh transformatorët të fuqisë, sipas projektit dhe standardit
- Instalon transformatorët të fuqisë, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh panelin e mbrojtjes, sipas projektit dhe standardit
- Instalon panelin e mbrojtjes, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh panelin e kontroll monitorimit, sipas projektit dhe standardit
- Instalon panelin e kontroll monitorimit sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh panelin e matjes sipas projektit dhe standardit.
- Instalon panelin e matjes, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh elementet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike, sipas projektit dhe standardit.
- Instalon sistemin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh kabllot e fuqisë së T.L., sipas projektit dhe standardit.
- Instalon kabllot e fuqisë, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh kokat e kabllit dhe bashkueset (muftet/xhuntot) e T.L., sipas projektit dhe standardit.
- Instalon kokat e kabllit dhe bashkueset (muftet/xhuntot), sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh kabllot e T.U deri 1000 V sipas projektit dhe standardit.
- Instalon kabllot e T.U. deri 1000 V, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh kabllot e rrymës së vazhduar sipas projektit dhe standardit.
- Instalon kabllot e rrymës së vazhduar, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh panelin elektrik (shpërndarësin T.U.), sipas projektit dhe standardit.
- Instalon panelin elektrik (shpërndarësin T.U.), sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh elementet e sistemit të ndriçimit të jashtëm dhe të brendshëm sipas projektit dhe standardit.
- Instalon sistemin e ndriçimit të jashtëm dhe të brendshëm, sipas procedurës dhe standardit;
- Përzgjedh elementet e sistemit të tokëzimit të Nënstacionit, sipas projektit dhe standardit.
- Instalon sistemin e tokëzimit të Nënstacionit, sipas procedurës dhe standardit;
- Realizon lidhjet elektrike ndërmjet pajisjeve sipas skemave teknike;
- Kontrollon shtrëngimin, izolimin dhe korrektësinë e lidhjeve elektrike;
- Kryen rregullimin dhe konfigurimin bazë të pajisjeve të instaluara;
- Kryen testimin funksional të pajisjeve dhe sistemeve të nënstacionit;
- Identifikon dhe korrigjon defektet gjatë procesit të instalimit;
- Dokumenton punimet dhe rezultatet e testeve sipas kërkesave teknike;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të instalimit;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në rrjetin e T.L.

NjN-05-III-0500-26 Instalimi i kabinës elektrike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë strukturën dhe funksionin e kabinës elektrike;
2. Të identifikojë komponentët kryesorë të kabinës elektrike;
3. Të përshkruajë llojet kryesore të kabinave elektrike sipas tensionit (T.U., T.M., T.L.) dhe ndërtimin e tyre;
4. Të shpjegojë kushtet teknike të ndërtimit dhe instalimit të kabinave elektrike;

5. Të përshkruajë procedurat e planifikimit dhe organizimit të punës për instalimin e kabinës elektrike;
6. Të shpjegojë procesin e montimit dhe lidhjes së komponentëve brenda kabinës elektrike;
7. Të përshkruajë procedurat e testimit dhe vënies në punë të kabinës elektrike;
8. Të identifikojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes personale gjatë punimeve në kabinën elektrike;
9. Të shpjegojë rëndësinë e tokëzimit dhe mbrojtjes ndaj rrymave të shkurtra në kabinën elektrike;
10. Të shpjegojë procedurat e dorëzimit dhe pranimit të punimeve të instalimit të kabinës elektrike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë analizimin e projektit elektrik të kabinës dhe verifikimin e materialeve dhe pajisjeve sipas specifikimeve teknike;
2. Të kryejë përgatitjen e ambientit të punës dhe përzgjedhjen e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve për instalim;
3. Të kryejë instalimin e pajisjeve komutuese, kontaktorëve, transformatorit të fuqisë dhe panelit shpërndarës;
4. Të kryejë instalimin e kabllave dhe lidhjeve elektrike të kabinës;
5. Të kryejë instalimin e sistemit të tokëzimit, ndriçimit dhe pajisjeve ndihmëse;
6. Të kryejë testimin, kontrollin dhe dokumentimin e instalimit të kabinës elektrike.

Kriteret e vlerësimit

- Lexon dhe interpreton saktë projektin elektrik të kabinës;
- Kontrollon përputhshmërinë e pajisjeve dhe materialeve me projektin teknik ;
- Përzgjedh materialet, mjetet dhe pajisjet e duhura për instalimin e kabinës elektrike sipas specifikimeve teknike;
- Përgatit ambientin dhe bazamentet për vendosjen e pajisjeve të kabinës elektrike;
- Instalon pajisjet komutuese sipas procedurës dhe standardeve;
- Instalon kontaktorët sipas procedurës dhe standardeve;
- Instalon transformatorin e fuqisë, sipas procedurës dhe standardeve;
- Instalon panelin shpërndarës sipas procedurës dhe standardeve;
- Instalon kabllot, sipas procedurës dhe standardeve;
- Realizon lidhjet elektrike ndërmjet pajisjeve sipas skemës elektrike;
- Etiketon kabllot, pajisjet dhe qarqet sipas dokumentacionit teknik;
- Kontrollon shtrëngimin dhe izolimin e lidhjeve elektrike pas instalimit;
- Instalon sistemin e tokëzimit sipas procedurës dhe standardeve;
- Instalon sistemin e ndriçimit sipas procedurës dhe standardeve;
- Verifikon funksionimin e sistemit të ventilimit/ftohjes së kabinës (kur parashikohet në projekt);
- Instalon tabelat parandaluese sipas procedurës dhe standardeve;
- Kryen testet e nevojshme të funksionimit të pajisjeve;
- Verifikon parametrat elektrikë (tension, rrymë, mbrojtje) me instrumente matëse;
- Identifikon dhe riparon defektet e hasura gjatë instalimit të pajisjeve të kabinës elektrike;
- Kryen kontrollin final të instalimit sipas standardeve;
- Dokumenton punimet dhe rezultatet e testeve sipas kërkesave teknike;

- Zbaton rregullat e sigurisë elektrike duke përdorur pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) gjatë çdo faze të punës;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të instalimit.

NjN-05-III-0501-26 Sistemi i matjes së energjisë elektrike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë konceptet bazë të matjes së energjisë elektrike: energjia aktive, reaktive, koeficienti i fuqisë ($\cos \varphi$);
2. Të identifikojë llojet e matësve të energjisë elektrike: matës elektromagnetik (induktiv), elektronikë dhe matës inteligjentë (smart meters);
3. Të përshkruajë strukturën dhe funksionimin e sistemit të matjes: transformatorët e rrymës (TC), transformatorët e tensionit (TT) dhe matësi;
4. Të shpjegojë skemat tipike të lidhjes së matësve të energjisë elektrike (lidhja direkte dhe indirekte);
5. Të përshkruajë procedurat e instalimit të transformatorëve të matjes (TC dhe TT) sipas normave teknike;
6. Të përshkruajë sistemet e leximit (lexim në distancë dhe në vend) dhe komunikimin e të dhënave të matjes;
7. Të identifikojë ndërhyrjet në sistemin e matjeve të energjisë elektrike;
8. Të përshkruajë masat e sigurisë gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të matjes;
9. Të interpretojë të dhënat e regjistruara nga matësi;
10. Të shpjegojë procedurat e zëvendësimit dhe vulosjes së matësve të energjisë elektrike;
11. Të shpjegojë pjesët përbërëse të transmetimit online;
12. Të përshkruajë procedurat e instalimit të pajisjeve të transmetimit online.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë analizimin e skemave të sistemit të matjes sipas projektit dhe standardeve.
2. Të kryejë përgatitjen e vendit të punës dhe përzgjedhjen e pajisjeve të matjes;
3. Të kryejë instalimin e transformatorëve të matjes dhe matësit të energjisë elektrike;
4. Të kryejë lidhjen dhe verifikimin e qarkut të matjes;
5. Të kryejë testimin dhe korrigjimin e gabimeve në sistemin e matjes;
6. Të kryejë dokumentimin, vulosjen dhe zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë instalimit të sistemit të matjes.

Kriteret e vlerësimit

- Lexon dhe interpreton saktë skemat e sistemit të matjes së energjisë elektrike;
- Kontrollon përputhshmërinë e skemës së matjes me projektin teknik dhe standardet përkatëse;
- Përgatit vendin e instalimit dhe siguron kushtet teknike për montimin e sistemit të matjes;
- Përzgjedh matësin sipas karakteristikave të rrjetit dhe kërkesave teknike;
- Përzgjedh transformatorin e matjes sipas karakteristikave të rrjetit dhe kërkesave teknike;
- Verifikon gjendjen teknike të matësit dhe transformatorëve të matjes përpara instalimit;
- Instalon transformatorin e rrymës (TC), sipas procedurës dhe standardit;
- Instalon transformatorët e tensionit (TT) sipas procedurës dhe standardit;
- Lidh saktë qarkun e matjes sipas procedurës dhe standardit;

- Kontrollon izolimin dhe shtrëngimin e lidhjeve në qarkun e matjes;
- Monton dhe fikson matësin e energjisë elektrike sipas procedurës dhe standardit;
- Verifikon lidhjen e qarkut të matjes sipas procedurës dhe standardit;
- Etiketon qarqet e matjes dhe lidhjet përkatëse;
- Kryen testin funksional të sistemit të matjes sipas procedurës dhe standardit;
- Identifikon saktë gabimet në sistemin e matjes;
- Merr masa për zgjidhjen e gabimit në sistemin e matjes sipas procedurës dhe standardit;
- Zbaton procedurat e vulosjes së matësit sipas procedurës dhe standardit;
- Kryen kontrollin përfundimtar të sistemit të matjes përpara vënies në punë;
- Plotëson formularët tip të dokumentacionit teknik të instalimit të sistemit të matjes;
- Zbaton rregullat e sigurisë elektrike duke përdorur pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) gjatë çdo faze të punës;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të instalimit.

NjN-05-III-0502-26 Mirëmbajtja e rrjetit të T.U.-T.M.-T.L

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit vizual të pajisjeve elektrike, kablllove, shtyllave, paneleve etj.;
2. Të shpjegojë procedurat e verifikimit për përcaktimin e defekteve në rrjetin T.U., T.M., T.L.;
3. Të shpjegojë masat që merren për parandalim të defekteve;
4. Të shpjegojë kategoritë e remonteve të rrjetit T.U., T.M., T.L.;
5. Të shpjegojë llojet e defekteve;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe procedurat e zëvendësimit dhe/ose riparimit të pajisjeve të dëmtuara të të rrjetit T.U., T.M., T.L.;
7. Të shpjegojë procedurën e kontrollit të parametrave (tension, ngarkesë) pas riparimit të defektit;
8. Të shpjegojë elementet e formateve tip të dokumentacionit të mirëmbajtjes.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë defektin në rrjetin elektrik me metoda vizuale dhe pajisje diagnostikuese;
2. Të përcaktojë procedurat, pajisjet dhe materialet për riparimin e defekteve;
3. Të kryejë riparimin, zëvendësimin dhe montimin e pajisjeve të dëmtuara;
4. Të zbatojë procedurat e mirëmbajtjes së rrjetit elektrik;
5. Të kryejë testimin dhe verifikimin e parametrave elektrikë pas ndërhyrjes.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon vizualisht dhe në kohë defektin ose problemin;
- Siguron shkëputjen e energjisë duke vendosur masat e sigurisë para ndërhyrjes;
- Analizon dokumentacionin teknik dhe historikun e defekteve;
- Përcakton procedurën e verifikimit të defektit;
- Përzgjedh pajisjet e duhura për përcaktimin e defektit;
- Inspekton vizualisht pajisjet dhe elementët e rrjetit elektrik;
- Lokalizon shkaktuesin e defektit me metoda dhe pajisje diagnostikuese;
- Përzgjedh bazën materiale që duhet për riparimin e defektit;

- Përzgjedh veglat e duhura të punës për riparimin e defektit;
- Identifikon në kohë masat që merren për parandalimin e defekteve;
- Zbaton masat e duhura për parandalimin e defekteve;
- Përzgjedh kategorinë e remonteve në rrjetin elektrik;
- Kryen remontin në rrjetin elektrik, sipas procedurës;
- Kryen remontin profilaktik në rrjetin elektrik, sipas procedurës;
- Kryen remontin e mesëm në rrjetin elektrik, sipas procedurës;
- Kryen remontin kapital në rrjetin elektrik, sipas procedurës;
- Zbaton procedurat e zëvendësimit të pajisjeve të dëmtuara të rrjetit elektrik;
- Zbaton procedurat e riparimit të pajisjeve të dëmtuara të rrjetit elektrik;
- Kryen pastrimin dhe mirëmbajtjen rutinë të pajisjeve sipas planit;
- Përdor aparatet e matjeve të kontrollit të parametrave (tension, rrymë) pas zgjidhjes së defektit;
- Teston funksionimin e sistemit pas zgjidhjes së defektit;
- Verifikon rikthimin e parametrave normalë të punës;
- Plotëson formularët tip të dokumentacionit të mirëmbajtjes dhe të defektit;
- Raporton defektet dhe ndërhyrjet e kryera sipas procedurës;
- Pastron dhe sistemon vendin e punës pas përfundimit të ndërhyrjes;
- Zbaton rregullat e sigurisë elektrike duke përdorur pajisjet mbrojtëse personale (PPE) gjatë gjithë procesit.

NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënësit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës që lidhet me aktivitetin profesional;
2. Të listojë llojet kryesore të dokumentacionit ligjor dhe financiar që përdoret në ushtrimin e aktivitetit (kontrata, fatura, raporte, regjistra);
3. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit, ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit sipas rregullave përkatëse;
4. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së nevojave për materiale dhe të planifikimit të grafikut të kohës së punës;
5. Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave në faturë dhe rëndësinë e saktësisë së tyre;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe elementët kryesorë të përgatitjes së një oferte për punime ose shërbime;
7. Të listojë llojet kryesore të raportimeve financiare (raporte shpenzimesh, të ardhurash, bilance të thjeshta);
8. Të përshkruajë mënyrat e informimit nga tregu në lidhje me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
9. Të përshkruajë elementët bazë të llogaritjes së kostos për mjete, materiale dhe pajisje pune;
10. Të identifikojë komponentët e kostos (kosto direkte dhe indirekte);
11. Të përshkruajë përmbajtjen e një oferte për punime/shërbime;
12. Të identifikojë elementët kryesorë të një oferte (përshkrimi i punës, çmimi, afatet, kushtet);
13. Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së ofertave për klientët;

14. Të përshkruajë konceptin e inventarit dhe rëndësinë e tij në biznes;
15. Të përshkruajë procedurat e furnizimit me materiale dhe pajisje;
16. Të identifikojë dokumentacionin e nevojshëm për furnizim (porosi, kontrata, fatura);
17. Të dallojë mënyrat e blerjes së mjeteve dhe materialeve (blerje direkte, me porosi, online);
18. Të përshkruajë kriteret për përzgjedhjen e furnitorëve;
19. Të shpjegojë elementët e llogaritjes së çmimit për shërbimet/punimet e ofruara;
20. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në çmim (kosto, tregu, konkurrenca, cilësia);
21. Të përshkruajë konceptin e fitimit dhe marzhit të fitimit;
22. Të dallojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve/shërbimeve (procesverbal, fletë-dorëzim, faturë);
23. Të përshkruajë përmbajtjen e dokumenteve të dorëzimit;
24. Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit korrekt të dorëzimit të punës;
25. Të përshkruajë konceptin e marketingut dhe rolin e tij në biznes;
26. Të identifikojë teknikat bazë të marketingut (promovimi, reklama, komunikimi me klientin);
27. Të shpjegojë rëndësinë e kënaqësisë së klientit dhe imazhit të biznesit;
28. Të përshkruajë mënyrat e promovimit të shërbimeve (rrjete sociale, rekomandime, ekspozim);
29. Të përshkruajë konceptin e komunikimit dhe metodat kryesore të tij në një mjedis profesional;
30. Të shpjegojë parimet bazë të punës në grup dhe rëndësinë e bashkëpunimit në realizimin e detyrave;
31. Të dallojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
32. Të shpjegojë parimet e Kodit të Etikës dhe rëndësinë e zbatimit të tij në vendin e punës;
33. Të përshkruajë metodat bazë të zgjidhjes së problemeve dhe rolin e mendimit kritik në situata pune;
34. Të identifikojë bashkëpunëtorët kryesorë në veprimtarinë profesionale dhe rolin e secilit;
35. Të shpjegojë përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin profesional;
36. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit korrekt të terminologjisë profesionale;
37. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave konfidenciale dhe mbrojtjes së informacionit;
38. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit (gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.) në mjedisin e punës;
39. Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes në aspektin profesional (pikat e forta, dobësitë, aftësitë dhe interesat);
40. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit në përmirësimin e performancës në punë;
41. Të identifikojë metodat e zhvillimit profesional (mësim gjatë gjithë jetës, trajnime, praktikë, mentorim);
42. Të përshkruajë konceptin e zhvillimit të karrierës dhe fazat e tij;
43. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të karrierës në fushën e tij;
44. Të identifikojë aftësitë e nevojshme për zhvillim profesional në tregun e punës;
45. Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore të përdorura në proceset e punës;
46. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të punës;
47. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe eksperiencës tek bashkëpunëtorët në vendin e punës;
48. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit profesional në transferimin e njohurive teknike;
49. Të identifikojë mënyrat e aplikimit të teknikave të reja në proceset e punës;
50. Të përshkruajë rëndësinë e inovacionit në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve;

51. Të dallojë llojet e panairëve profesionale dhe ekspozitave industriale;
52. Të shpjegojë rolin e panairëve dhe ekspozitave në promovimin e produkteve dhe krijimin e kontakteve profesionale;
53. Të identifikojë llojet e trajnimeve profesionale (fillestare, të avancuara, specializuese);
54. Të përshkruajë rëndësinë e kurseve teknike në përmirësimin e aftësive praktike dhe teorike;
55. Të shpjegojë konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (lifelong learning);
56. Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes me ndryshimet teknologjike në profesion;
57. Të identifikojë burimet e informacionit për zhvillim profesional (internet, manuale, kurse, kolegë, institucione);
58. Të shpjegojë rëndësinë e punës në ekip në zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e eksperiencave;
59. Të përshkruajë mënyrat e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive personale dhe profesionale;
60. Të identifikojë mundësitë e punësimit dhe zhvillimit në sektorin energjetik.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë procedurat ligjore dhe dokumentacionin profesional gjatë veprimtarisë së punës;
2. Të plotësojë dhe arkivojë dokumentacionin ligjor, financiar dhe teknik;
3. Të planifikojë nevojat për materiale, kohën e punës dhe koston e punimeve;
4. Të menaxhojë ofertat, furnizimin dhe procesin e dorëzimit të punimeve;
5. Të komunikojë në mënyrë profesionale duke përdorur TIK-un dhe duke respektuar etikën e punës;
6. Të përmirësojë performancën profesionale përmes zgjidhjes së problemeve, vetëvlerësimit dhe trajnimeve të vazhdueshme.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton saktë procedurat ligjore dhe dokumentacionin profesional në të paktën 90% të rasteve të punës;
- Plotëson dhe përdor pa gabime dokumentacionin ligjor dhe financiar (kontrata, fatura, raporte, regjistra);
- Përpilon dhe arkivon dokumentacionin teknik sipas standardit në mënyrë të rregullt dhe të plotë;
- Planifikon nevojat për materiale dhe kohën e punës me devijim jo më shumë se 10% nga realizimi;
- Llogarit saktë koston e punimeve me devijim maksimal të pranueshëm deri në 5–10%;
- Përgatit oferta profesionale që përfshijnë të gjithë elementët (përshkrim, çmim, afat, kushte) pa mungesa;
- Përdor saktë metodat e furnizimit dhe përzgjedh furnitorët sipas kriterëve të përcaktuar;
- Zbaton procedurat e dorëzimit të punimeve duke përgatitur dokumentacionin përkatës pa gabime;
- Komunikon në mënyrë profesionale në situata pune duke respektuar rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Përdor TIK-un për komunikim dhe dokumentim profesional në mënyrë funksionale dhe të saktë;
- Zgjidh problemet profesionale në mënyrë të pavarur në të paktën 80% të rasteve;
- Zbaton rregullat e etikës dhe siguron sjellje profesionale në të gjitha situatat e punës;

- Respekton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në të gjitha aktivitetet profesionale;
- Përdor teknologjitë bashkëkohore në mënyrë efektive gjatë procesit të punës;
- Përmirëson performancën profesionale përmes vetëvlerësimit dhe trajnimeve të vazhdueshme.

NjN-05-III-0503-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në T.U., T.M. dhe T.L.

Rezultatet e të nxënit në njohuri

- Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të identifikojë procedurat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të interpretojë sinjalistikat dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të shpjegojë përdorimin dhe funksionin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri (MZSH);
- Të përshkruajë masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike;
- Të shpjegojë konceptin dhe karakteristikat e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve;
- Të identifikojë rregulloret përkatëse për depozitim të mbetjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve;
- Të identifikojë pajisjet mbrojtëse personale dhe funksionin e tyre në sigurinë në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të pajisjeve mbrojtëse personale;
- Të përshkruajë pajisjet e thjeshta për kontrollin e rrjetit elektrik;
- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e verifikimit të sigurisë së kabllave dhe pajisjeve elektrike;
- Të përshkruajë rëndësinë e testimit të pajisjeve elektrike për funksionim të sigurt;
- Të dallojë llojet e tabelave të kufizimit dhe sinjalistikës për sigurinë teknike;
- Të shpjegojë protokollin e duhur të veprimit në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat dhe standardet e sigurisë në punë dhe legjislacionin përkatës;
2. Të përdorë manualin, pajisjet dhe mjetet e punës sipas udhëzimeve teknike;
3. Të zbatojë procedurat e ndihmës së parë, evakuimit dhe veprimeve në emergjencë;
4. Të përdorë pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) dhe pajisjet kundër zjarrit sipas rregullave;
5. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbetjeve dhe magazinimit të materialeve;
6. Të kontrollojë pajisjet, kabllot dhe sistemet elektrike për siguri dhe funksionim korrekt;
7. Të zbatojë sinjalistikën e sigurisë dhe protokollin e emergjencës në vendin e punës.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton standardet dhe legjislacionin për sigurinë në punë sipas rregullave të sigurimit teknik;
- Përdor manualin e mjeteve dhe pajisjeve të punës gjatë veprimtarisë profesionale;

- Identifikon dhe zbaton procedurat e ndihmës së parë në rast aksidenti në vendin e punës;
- Interpretin saktë sinjalistikat dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
- Zbaton procedurat e evakuimit në raste emergjence sipas protokolleve të sigurisë;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes nga zjarri (MZSH) sipas funksionit dhe rregullave teknike;
- Zbaton masat e sigurisë gjatë përdorimit të substancave dhe solucioneve kimike;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve në vendin e punës;
- Identifikon dhe zbaton rregulloret për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve;
- Raporton mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas procedurës;
- Zbaton rregullat e ruajtjes dhe magazinimit të materialeve në mënyrë të sigurt;
- Identifikon dhe përdor pajisjet mbrojtëse personale (PPE) sipas funksionit të tyre;
- Kontrollon gjendjen dhe funksionalitetin e pajisjeve mbrojtëse personale;
- Përdor pajisjet e thjeshta për kontrollin e rrjetit elektrik sipas procedurës;
- Verifikon sigurinë e kablove dhe pajisjeve elektrike para përdorimit;
- Teston funksionimin e pajisjeve elektrike për siguri operative;
- Zbaton tabelat dhe sinjalistikën e kufizimit dhe sigurisë në vendin e punës;
- Vepron sipas protokolleve të emergjencës në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Bazat e elektroteknikës në T.U., T.M. dhe T.L.	13	NjN-05-III-0493-26
2	Sistemi energjetik	4	NjN-05-III-0494-26
3	Vizatimi teknik në sistemin elektrik	4	NjN-05-III-0495-26
4	Pajisjet, mjetet dhe materialet e punës në T.U., T.M. dhe T.L.	7	NjN-05-III-0496-26
5	Instalimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe të mesëm	16	NjN-05-III-0497-26
6	Instalimi i rrjetit të linjave të tensionit të lartë	9	NjN-05-III-0498-26
7	Instalimi i rrjetit të tensionit të lartë në nënstacionin elektrik	12	NjN-05-III-0499-26
8	Instalimi i kabinës elektrike	9	NjN-05-III-0500-26
9	Sistemi i matjes së energjisë elektrike	8	NjN-05-III-0501-26
10	Mirëmbajtja e rrjetit të T.U.-T.M.-T.L.	10	NjN-05-III-0502-26
11	Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	4	NjN-24-III-0492-26
12	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në T.U., T.M. dhe T.L.	4	NjN-05-III-0503-26
	Total	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuara.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: E10-III-26

E - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

10 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

26 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-05-III-0493-26

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

05 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

III – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0493 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

26 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit